

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

1(nje) Inspektor Taks Force

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

1. Në bashkëpunim me përgjegjësin e Task Forcë harton planet e punës dhe i miraton ato tek Administratori, si dhe ndjek zbatimin e tyre.
2. Dokumenton dhe raporton me shkrim cdo ditë tek Përgjegjësi I task-forcës aktivitein ditor apo punën e kryer në grup.
3. Zbaton punën sipas planit të punës të miratuar.
4. Është personi përgjegjës kryesor që mban komunikimin me individët/subjektet gjatë kontrolleve që ushtrohen.
5. Në çdo verifikim apo konstatim perpilon me shkrim një akt-konstatim, në lidhje të paligjshme, ndërhyrje në matës, dhe kërkon menjëherë prezencën e Hidraulikut të shoqërisë, kjo për argumentimin teknik.
6. Nënshkruan aktet e mbajtura nga Grupi Task-Force për konstatimin e kundravajtjeve administrative në rrjetin e ujësjellësit, vendosjen e gjobave si dhe kallëzimeve penale konform VKM nr. 1304, date 11.12.2009 dhe Kodit Penal te Republikës se Shqipërisë;
7. Zbaton aktet ligjore e nënligjore ne fuqi për evidentimin dhe ndjekjen e rasteve te kundravajtjeve administrative dhe atyre penale.
8. Kujdeset që aktet e përpiluara te nënshkruhen nga i gjithë grupi i Task-Force dhe kundravajtësi dhe në rast refuzimi të shënohet ky fakt në procesverbal.

9. Merr masat sipas dispozitave ligjore, për të gjitha shkeljet e konstatuara ndaj individë/subjekte të ndryshme.
10. I raporton përgjegjësit të task-forcës, të gjitha rastet e shkeljeve të punonjësve të terrenit, duke dhënë përshkrimin të fakteve dhe rrethanave në të cilat është kryer kundravajtja.
11. Në plotësimin e proces-verbaleve duhet të jenë prezent jo më pak se 3 (tre) persona.
12. Gjate verifikimeve dhe punës ditore duhet të mbaje veshjen përkatëse (jeleket) e caktuar nga shoqëria si dhe mjetin identifikues të shoqërisë.
13. Zbaton rregullat e disiplinës në punë.

Kandidatet duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Çertifikatë personale
5. Çertifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Çertifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 5 dite.

Kandidatet do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesit në portalin “ Sherbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kane te drejte te ankimohen prane Drejtorise se Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit eshte 3 (tre) dite nga data e shpalljes se fituesit.